

-  
=



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
*Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa*  
*Izborni Panel za Žalbe i Predstavke*

**A nr. 1184/2013**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muharrem Shala kryesues, Xhevdet Abazi dhe Hasan Shala anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesat e Xhavit Alija – Kandidatë për Anëtarë të Kuvendit Komunal (AAK) dega në Gjakovë, paraqitur kundër Komisionerëve të Vendvotimit (KVV), për shkak të manipulimit me vota, të zgjedhjeve lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, mori këtë:

### **V E N D I M**

**Refuzohen si të pabazuara ankesat:** Anr.1184, Anr.1185, 1186, 1187, 1188 të datës 03.12.2013, të Xhavit Alija – Kandidatë për Anëtarë të Kuvendit Komunal (AAK) dega në Gjakovë.

### **Arsyetim**

PZAP-i, ka pranuar ankesat: Anr.1184, Anr.1185, 1186, 1187, 1188 të datës 03.12.2013, të Xhavit Alija – Kandidatë për Anëtarë të Kuvendit Komunal në Gjakovë në të cilat ankesa pretendohet se ka pasur keqpërdorime dhe manipulime të votave.

- Në ankesën Anr.1184/13 të datës 03.12.2013, pretendohet se në QV0223C kërkoi rinumërimin e votave pasi që konsideroi se numëri i votve është bërë gabim, ngase në të njëjtën QV kanë votuar familjarët e mi.
- Në ankesën Anr.1185/13 të datës 03.12.2013, pretendohet se në QV 0221 kërkoi rinumërimin e votave pasi që më mungojnë vott e familjarëve të mi, konsideroi se komisionarët i kanë numëruar votat gabim.
- Në ankesën Anr.1186 të datës 03.12.2013 , pretendohet se, në QV 0214C duhet të jenë 76 vota, ndërsa janë vetëm 31 vota pasi që kanë votuar familjar, prandaj kërkoi rinumërimin e e gjitha votave në këtë QV për shkak të numërimit të gabuar.
- Në ankesën Anr.1187/13 të datës 03.12.2013, pretendohet se në QV 0209C bazuar në persona të afërm që më kanë votuar më mungojnë votat, prandaj kërkoi që në të njëjtën QV të bëhet rinumërimi i votave.

- Në ankesën Anr.1188/13 të datës 03.12.2013 pretendohet se në QV 0213C kërkoi rinumërimin e votave, pasi që komisionarët i kanë numëruar votat gabimisht dhe mungojnë votat e të afërmeve të mi.

Bazuar në nenin 6.3 të “Rregullave dhe Procedurave” të PZAP-it, në të cilin parashihet se: “Me qëllim të lehtësimit të shqyrtimit të ankesave, Kryesuesi i Panelit mund të vendos ta bëjë bashkimin e ankesave që përmbajnë në vete çështje të ngjashme, paneli vendim-marrës i trajton ato ankesa sikurse të ishin një ankesë”. Në rastin konkret Kryesuesi i Panelit duke u bazuar në dispozitën ligjore të lartcekur ka vendosur ti bashkoi ankesat e sipërshënuara dhe ti trajtoi si një ankesë.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi ankesat gjeti se:

### **Ankesat janë të pa bazuara**

Pretendimet ankimore nga ana e Xhavit Alija – Kandidatë për Anëtarë të Kuvendit Komunal në Gjakovë, paraqitur kundër Komisionit të Vendvotimit (KVV), ku dyshohet për pa rregullsi dhe keqpërdorime si dhe munges të konsiderueshme të votave nëpër QV, mirëpo nuk është ofruar asnjë provë relevante nga ana e palës ankuese, me të cilat do të mund të vërtetoheshin shkeljet e supozuara.

Prandaj për shkakun se nuk janë ofruar dëshmi bindëse për të vërtetuar se kanë ndodhur dhe janë evidentuar pa rregullsi dhe keqpërdorime gjatë procesit të votimit në QV, të lartcekura nga parashtruesi i ankesës, PZAP-i konstatoi se pretendimet ankimore janë të përgjithshme dhe të pa qarta për tu vërtetuar dhe ankesat e lartpërmendura u refuzuan si të pa bazuara, prandaj duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesat e lartë përmendura u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

A nr. 1184/2013 më datën 06.12.2013

**Kryesuesi i Panelit**  
**Muharem Shala**



**Këshillë juridike:** Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda 24 orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.